



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1482/3 Prot.

Tiranë, më 13.11.2019

V E N D I M

Nr.131, datë 13.11.2019

“Për pezullimin e procesit të verifikimit, lidhur me rishikimin e kategorisë së pagës për pozicionet “Specialist”, në Drejtorinë e Vlerësimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorinë e Performancës, pranë ASCAP”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të neneve 77 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të kërkesës së ardhur nga 19 punonjës të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), regjistruar pranë Komisionerit me nr.1482 prot., datë 30.9.2019,

VËREJ SE,

Kërkesa e regjistruar nga 19 Specialistë të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorisë së Performancës, në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), drejtuar Departamentit të Administratës Publike, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë dhe për dijeni, Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, parashtron faktin se, pas ristrukturimit të institucionit, ka ndryshuar niveli i pagës për këta punonjës, nga III-b në nivelin IV-a, ndërkohë që pretendohet se, detyrat funksionale, janë të një niveli më të lartë, duke kërkuar në këtë rast, rivlerësimin e pozicionit të punës “Specialist” në drejtoritë si më sipër.

Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe komunikimit verbal me institucionet përkatëse, të cilave u janë drejtuar punonjësit e ASCAP (DAP dhe MASR), Komisioneri, u vu në dijeni të faktit se, këto institucione, ishin në fazën e bashkëbisedimit dhe shqyrtimit të pretendimit të ngritur nga këta punonjës.

Në vijim të komunikimit, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në shkresën kthim përgjigje punonjësve të ASCAP, me nr. 8897/2 prot., datë 28.10.2019, "*Kthim përgjigje kërkesave nr.8897 prot., nr.8897/1 prot., të një grupi specialistësh në ASCAP*", dërguar për dijeni Komisionerit, ka sqaruar arsyet në lidhje me ndryshimin e nivelit të pagës nga III-b në IV-a, për punonjësit e ASCAP.

Më konkretisht, në këtë shkresë është argumentuar se, në zbatim të vendimit nr.98, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, "*Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)*", Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), janë riorganizuar në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe për pasojë, u krye procesi i ristrukturimit, ku të gjithë punonjësit e IZHA dhe ISHA, u pozicionuan pranë ASCAP.

Gjatë këtij procesi, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe të pikës 20, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*", sipas vendimit të DAP për transferimin e përhershëm, të gjithë punonjësit, kanë nënshkruar deklaratën ku shprehin dakordësinë e tyre për pranimin e pozicioneve të reja të punës pranë ASCAP.

Në lidhje me nivelin e pagës, sqarohet më tej në shkresë, në zbatim të Vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës....institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*", të ndryshuar, ku pozicioni i punës "*Inspektor*" përcaktohet me kategori page III-b, punonjësit e Institutit Shtetëror të Arsimit (të cilët kanë ngritur pretendimin), ishin përfshirë në këtë kategori page, për shkak se, pozicioni i tyre i punës kishte emërtesën "*Inspektor*".

Sipas Urdhrit nr. 69, datë 5.4.2019, të Kryeministrit, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar*", në organikën e këtij institucioni, nuk është parashikuar pozicion pune me emërtesën "*Inspektor*", por vetëm pozicione pune me emërtesën "*Specialist*". Sipas lidhjes 7, të pikës 1/3, shkronja "b", të VKM nr.187, datë 8.3.2017, kategoria e pagës për pozicione pune me emërtesën "*Specialist*", në institucionet e varësisë, paguhet me kategorinë e pagës IV-a.

Në këto kushte, kategoria e pagës, mund të ndryshojë vetëm në rast se, punonjësit e ASCAP, në bazë të ligjit nr.10433, datë 16.6.2011, "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, do të kryejnë funksione inspektimi dhe të marrin emërtesën "*Inspektor*". Në këtë rast, funksionet e inspektimit, duhet të jenë të parashikuara në

vendimin e krijimit të ASCAP, në Rregulloren e Brendshme, si dhe në përshkrimet e punës për ato pozicione që do të kategorizohen në emërtesën “Inspektor”.

Mbështetur në këto argumenta, si dhe duke patur parasysh kërkesat ligjore në lidhje me përshkrimin e punës, të përcaktuara në Vendimin nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar, dhe Udhëzimin nr.1, datë 31.5.2017, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në konkluzionin se, kryerja e procesit të rivlerësimit të pozicioneve të punës “Specialist”, në ASCAP, kërkon hartimin e përshkrimeve të punës për këto pozicione në mënyrë që, duke dalë qartë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore, të mund të përcaktohet nëse këto pozicione kryejnë apo jo funksione inspektimi, për ta reflektuar më pas këtë proces në emërtesë dhe në nivelin e kategorisë së pagës.

Në rrethanat si më sipër, si dhe në kushtet kur institucioni është në fazën e hartimit të rregullores së brendshme dhe të përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, komisioneri vlerëson se, deri në përfundimin e tyre, duhet të vendoset pezullimi i procesit të verifikimit të informacionit të ardhur nëpërmjet kërkesës me nr.1482 prot., datë 30.9.2019, nga punonjësit e ASCAP, për rivlerësimin e pozicionit të punës “Specialist”.

Për këto arsye:

Bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 66, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të pezulloj procesin e verifikimit të informacionit të ardhur nëpërmjet kërkesës nr.1482 prot., datë 30.9.2019, të punonjësve të ASCAP, deri në momentin e përfundimit të procesit të rivlerësimit të pozicioneve të punës nëpërmjet hartimit të përshkrimeve të punës dhe rregullores së brendshme të institucionit dhe më tej, në reflektimin e këtij procesi, në nivelin e kategorisë së pagës.
2. Detyrimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të njoftojë me shkrim Komisionerin, për përfundimin e procesit, në lidhje me rivlerësimin e pozicionit të punës “Specialist”, pranë ASCAP.

3. Për këtë vendim të njoftohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Departamenti i Administratës Publike dhe Agjencija e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA